

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 344, Datë 23.12.2025****MBI****RAPORTIMIN NË ERE TË INFORMACIONIT PËR SIGURIMIN E ASETEVE DHE TË
JETËS DHE SHËNDETIT TË PUNONJËSVE NGA SUBJEKTET E LICENCUARA NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; Licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.06.2016; si dhe nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 3122 prot., datë 22.12.2025, “Mbi raportimin në ERE të informacionit lidhur me sigurimin e asetëve dhe të jetës dhe shëndetit të punonjësve nga subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- ERE në mbështetje të nenit 37 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për lëshimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të licencave në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, është miratuar licenca tip për prodhimin e energjisë elektrike, e cila në pikën 2.5 parashikon detyrimin e të licencuarve për të siguruar jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe asetet që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit, jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i licencës.
- Detyrimi për sigurimin e asetëve dhe të punonjësve është parashikuar gjithashtu edhe në kontratat e nënshkruara ndërmjet subjekteve prodhuese dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjeneruese të energjisë elektrike.
- Pika 3.2.2 e licencës për prodhimin e energjisë elektrike parashikon detyrimin e të licencuarve për të paraqitur pranë ERE-s, deri më 31 janar të çdo viti, raportin vjetor lidhur me operimet e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm.
- Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme përcaktimi i një afati të unifikuar për raportimin pranë ERE-s të informacionit lidhur me përmbushjen e detyrimit për sigurimin, me qëllim

disiplinimin e praktikës së raportimit, rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të kushteve të licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Afati për raportimin në ERE lidhur me sigurimin sipas përcaktimeve të kontratës për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjenerues të energjisë elektrike dhe kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike do të jetë data 31 janar e çdo viti.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë gjithë subjektet e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI